

VENDIM
Nr. 155, datë 6.10.2016

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “XHENGO ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN
E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; nenit 37, pika 2, germa “d”; të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 21 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; gjithashtu, dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4./10, gerrat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti